

AKT THEMELIMI DHE STATUT "Klaudia 30" SHPK

**AKTI 1 THEMELIMIT DHE STATUTI 1
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Klaudia 30 "**

KREU 1

HYRJE

Neni 1

Shoqeria me përgjegjësi të kufizuara " **Klaudia 30** " sh.p.k është themeluar nga ortaku:

- **Klea Dardha**, atësia Lulezim, amësia Aida, shtetas Shqiptar, lindur në Kuçovë dhe banues në KUÇOVË, me adresë Lagja "Llukan Prifti", Pallati Nr 40, kat i 8 (tete), apartamenti nr 14, Kuçovë; 5301; Kuçovë, lindur më 23/12/ 1998, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me LeternjoftimPashaporte nr BI2952197 dhe nr. Personal J86223050B

Themeluesi, i cili është madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin " Për Tregtaret dhe shoqëritë tregtare" hartojnë edhe statutin e Shoqërisë si më poshtë:

**KREU II
PERKUFIZIME**

Neni 2

Emertimi i shoqërise:

Emertimi i shoqërisë është "**Klaudia 30**"

Neni 3

Asambleja e ortakëve ka vendosur miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shoqërisë, vecanërisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statute. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qëndrën Kombetare të Regjistrimit. Gjithashtu shoqëria e bazon aktivitetin e saj në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurencës" të ndryshuar, në Kodin Civil dhe Kodin e Punës si dhe në ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Forma

Shoqëria "**Klaudia 30**" sh.p.k është "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara"



**NENI 5
SELIA**

1. Selia e Shoqërisë do të jetë "Tirane, Bulevardi Kashari, Rruga Sokrat Miho, Zone Kadastrale 3866, me numer pasurie 213/146".
2. Shoqëria ka të drejtë të hapi filial të tjera brënda territorit të Republikë së Shqipërisë në varësi të selisë qëndrore që ndodhet në rrithin e Tiranës.
3. Vendi i mbajtjes së asamblesë së përgjithshme është selia e shoqërisë. Nëse bihet dakort me unanimitet, mbledhja e asamblesë mund të kryhet në një vënd tjeter.

**NENI 6
OBJEKTI 1 VEPRIMTARISË SHOQËRISË**

Objeti i veprimitarise se shoqerise do te jetet:

- Transferta dhe pagesa per emer dhe Illogari te Institucionit financiar Jobanke, Ak-Invest sha

**NENI 7
VULA E SHOQËRISË**

1. Shoqëria ka vulën e saj, në brëndësi të së cilës shkruhet i plotë emërtimi dhe forma e saj juridike.
2. Të gjitha aktet që dalin nga shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulen me vulën e shoqërisë.

**NENI 8
KOHEZGJATJA E SHOQËRISË**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

**NENI 9
VEPRIMET E LEJUARA TË SHOQËRISË**

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimitarise së saj sipas vendimeve që do të marrë asambleja e Përgjithshme me shumicen e ortakeve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëve të kapitalit.

**NENI 10
MARRËDHËNIA E PUNËS**

1. Shoqëria për të kryer veprimtarinë e saj sipas objektit të këtij statute do të lidhë kontrata individuale për të rregulluar marredheniet e punës.
2. Kontratat e punës do të lidhen konform ligjit " Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" dhe dispozitave të tjera ligjore që rregullojnë marredheniet e punës në Republikën e Shqipërisë.

**KREU III
PARIMI 1 DETYRIMIT TË BESNIKËRISË**

**Neni 11
Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur**

Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose mbikeqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyje në marredhenie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse nuk deklarohen kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektit e

interest të tij e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej te gjithë ortakeve ose të gjithë ortakëve të tjera.

2. Cdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qëndrën Kombëtarë të Regjistrimit.
3. Miratimi I parashikuar jepet, gjithashtu për cdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me palë të tretë, e Cila ka marredhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar Ose për të mbikqyrur shoqërine, apo me palë të tjera, marrëdhëni e tē cilave me personat e mësipër janë të lidhur që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundershtim me interest e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interesat e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqërinë:
 - a. a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit Ose motra e bashkëshortit/bashkëshortes;
 - b. b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve Ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
 - c. c) personat e lidhur me personelin e autorizuar për të përfaqësur ose për të mbikqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit Ose të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi Ose i birësuari, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
 - d. d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikwrur shoqërinë.
4. Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij nenit, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorume.
5. Cdo veprim që kërkon miratim, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij nenit, publikohet në pascyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interest të personave të përfshirë.
6. Për efekt të këtij statute, me persona të autorizuara për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqërinë tregtare do të kuptojmë ortakët e shoqërise, administratorin, ekspertin kontabël të autorizuar dhe likuiduesin e shoqërisë.

NENI 12 **PARIMI 1 BESNIKËRISË**

1. Gjat ushtrimit të tē drejtave, ortakët veprojnë, duke marre parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjera. I njëjtë detyrim zbatohet edhe për administratorët.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligji ose nga ky statut, në rrethana të tjera, ortakët gjëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

NENI 13 **NDALIMI 1 KONKURENCES**

1. Personat e autorizuar për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqërinë tregtare mund mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektorë ekonomik me shoqërinë e pare.
2. Ndalimi I përmëndur në pikën 1 të këtij neni të shfuqizuar nëpërmjet një autorizimi të posacem, të dhënë nga ortakët nga asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar.



3. Ndalimi I përmendur në pikën 1 të këtij nenit, të mbetur në fuqi edhe pas humbjes së cilësisë apo statutit të përmendur në të, për një periudhë një vit pas humbjes së kësaj cilësie.
4. Nëse ndonjëri prej personave të përmëndur në pikën 1 të këtij nenit shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:
 - a) ta përsashtoje atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
 - b) të kërkojë ndërprerje të veprimtarisë konkureuese;
 - c) të ngrejë paq i për shpërblimin e dëmit.
5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij nenit:
 - a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
 - b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari te personave te trete
 - c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.
6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brënda tre viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmëndur zbatohen, gjithashu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të ligjit " Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

Kreu IV KAPITALI THEMALTAR - PJESMARRJA

1. Kapitali i shoqërise ka vlerën 500.000 Leke(peseqind mijë leke) e Cila perfaqeson 1 (një) kuota.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e Cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prekë të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zvogelohet nën kufirin minimal që lejon ligji " Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

Neni 15 Kontributet

Kapitali i shoqërisë do të jetë 500.000 (peseqind mijë), zotërohet nga ortaku i vetem i shoqërisë:

- **Klea Dardha**, zotëron **1** Kuota ose 100 % te aksioneve me vlerë 500.000Leke(peseqind mijë leke).

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.



Neni 16

Kalimi i kuotave të kapitalit

Kuotat e kapitalit të shoqërisë janë të kalueshme ndërmjet ortakëve dhe të kalueshme në rrugë trashëgimie. Trashegimtari paraardhësi ose pasardhësi, bëken ortakë, nëpërmjet kalimit të kuotave të kapitalit.

2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund tu kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{1}{2}$ e pjesëve të kapitalit.
3. Në rast kur njëri apo disa nga ortakët dëshirojnë të kalojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje tu behet ortakeve të tjerë të shoqërisë. Kur ortakët që gjëzojnë të drejtën e parablerjes kanë dyshime rreth cmimit të kuotave të ortakut që kërkon ti kaloj ato, mund ti drejtohet gjykatës që të caktoj një ekspert vlerësues. Ortaku që kërkon kalimin e kuotave te të tretët duhet te lajmërohet në një afat sa më të shpejtë, nëse brenda 4 javëve ortakut nuk I jepet një përgjigje atëherë prezumohet se ortakët e tjerë kanë rën dakort që kuotat e tij mund ti kalojnë të tretëve.
4. Kalimi i kuotave do të bëhet me kontratë.
5. Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

Neni 17

1. Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

KREU V

ORGANET E SHOQËRISE, KUORUMI DHE ZGJEDHJA E TYRE

NENI 18

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

1. Cdo ortakë ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron.
2. Ortaku mond të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjeter I zgjedhur prej tij, me kusht që këta të janë autorizuar me prokurë (përjashtohet përfaqësimi I një ortaku nga një ortak tjeter apo administrator I shoqërisë).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jetë vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese në të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertët kontabël të autorizuari, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët , të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votive në Asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Këta ortakë mund ti drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e cështjeve të posacme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe rështjet nër të cilat asambleja duhet të marrë nië vendim. Nëse kërkesa refuzohet

këta ortake kane të drejtë ta thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe të caktojnë cështjen e rendit të ditës. Njoftimi do të bëhet me shkresë ose nëpërmjet pastës elektonike.

6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbaje vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës t'u dergohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nëse në kundërshtim me pikën 5 të këtij nenit, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose cështja e këruar prej tyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që ka bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi " Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".
8. Lajmërimi për mbledhjen e Asamblesë së Pergjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e përgjithshme merr vendime për cështjet e mëposhtme dhe është ~~përgjese~~ për to:
 - a) Përcaktimi I politikave tregtare të shoqerisë; ndryshimet e statutit;
 - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;
 - c) Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likujduesit dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasurave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë
 - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë (pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit përkatës);
 - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit përkatës);
 - h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - k) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
 - l) Cështje të tjëra të parashikuara nga ligji;
10. Të gjitha vendimet të marra nga Asambleja e Përgjithshme rregistrohen ne një regjistër të vendimeve, të dhëna të cilat nuk mund të ndryshohen apo të fshihen.
11. Duhen rrugistuar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) Miratimin e Pasqyrave Financiare Vjetore dhe të Raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
 - b) Shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) Investime;
 - d) Vendime për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e parregjistruar në regjistrin e vendimeve janë automatikisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të zakonshme për cështje të tillë si emërimi ose shkarkimi I administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimi I raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi I pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marre vendime të vlefshme vetëm nese marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave dhe vendimet merren me më shumë se gjysma e votive të ortakëve pjesëmarrës.

15. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të kualifikuar për ceshtje të tilla si ndryshimet e statutit, zmadhimi dhe wogëlimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likujdimi I saj, shndërrimi I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjeter që parashikohet në ligj. Marrja e vendimevetë vlefshme bëhet vetëm nëse oftakët që zotërojn më shumë se 50% e kuotave janë të pranishme, votojnë me shkresë apo mjete elektronike. Në këtë rast vendimet merren me $\frac{3}{4}$ e votive të ortakëve pjesmarrës.

16. Në se asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në këtë pikë, të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30ditë, me të njëtin rend dite.

NENI 19 **ADMINISTRIMI**

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator të cilët janë persona fizikë të zgjedhur Brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati I emetimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes. Ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi competent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi I administratorëve prodhon efekt pas regjistrimit në Qëndrën kombëtare të Rëgjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblesë së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

NENI 20 **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarosë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencen r shoqërisë;
 - f) Krijojnë rregjistrime dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në Qëndrën Kombëtare të Rëgjistrimit ;
 - g) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme përsaparashikon ky statut Ose ligji.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumice të zakoshme.



NENI 21
EMËRIMI I PARË I ADMINISTRATORËVE

Administratori i shoqërisë për periudhën 5-vjecare emërohet Klea Dardha, atësia Lulezim, amësia Aida , shtetase Shqiptare, lindur në Kuçovë, Berat dhe banues në adresë Lagjia "Llukan Priti", Pallati Nr 40, kati i 8 (tete), apartamenti nr 14, Kuçovë; 5301; Kuçovë, lindur më 23/12/ 1998, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim pashaporte nr BI2952197 dhe nr. Personal J86223050B.

NENI 22
EKSPERTË KONTABËL TË AUTORIZUAR

1. Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli financiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e përgjithshme me shumicë të zakonshme.
2. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emerimi i tij, në rast se vërtetohen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

KREU VI

VOTA

Neni 23

E drejta e votës

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote. Cdo ortak votat që ka mund ti japi vetëm në uniformitet.

Neni 24

E drejta për të kaluar rezolutë

Asambleja e përgjithshme munt të miratojë rezolutë pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj, Që të miratoket një rezolutë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të jenë të pranishme të gjithë ortakët personalisht dh eta votojnë atë në mënyrë të unifikuar.

KREU VII
MARRËDHËNIET FINANCIARE

Neni 25

Viti Financiar

Cdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Neni 26

Bilanci Vjetor

1. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet financiare dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja e përgjithshme e zakonshme.
2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhen brënda një afati prej tre muajsh raga data e mbylljes së vitit financiar.
3. Gjuha që përdoret në miratimin e dokumentave është gjuha shqipe.

Neni 27
Dividentët

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, asambleja e përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividentëve mbi fitimin në raport me kuatat që gjithsecili ka në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në raport me kuotat, përbëhet nga fitimi i vitit finanziar të cilin I janë zbritur shumat e lena mënjanë për fondin reserve të domosdoshëm (5% e fitimit të cdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjeter I janë zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 28
Marredhenia me bankat dhe institucionet financiare

Shoqeria ka te drejte te hap llogari likuiduese prane nje ose me shume bankave ose institucioneve financiare dhe te kryeje veprime likuiduese prane bankave. Ne keto banka ose institucione financiare si nenshkrim i pare do tö depozitohet ai i administratorit te shoqerise, i cili duhet te nenshkruaj per te gjitha veprimet financiare ne emer e per llogari te shoqerise. Ai mund tö autorizoje edhe persona te tjere brenda shoqörise.

Neni 29
Marrëdhënia me organet tativore.

Veprimtaria ekonomike e shoqorisë mbaron më 31 dhjetor të cdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij janë të detyruar tö paraqesin bilancin vjetor dhe deklarimin e të ardhurave , dhe ti dorzoj pranë organit përkatës të tatimeve.

KREU VIII
NDRYSHIMI I STATUTIT TË SHOQËRISË

Neni 30
Prishja e shoqërisë

1. Shoqëria prishet me perfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj.
2. Shoqëria nuk prishet kur njëri prej ortakëvë falimenton, bëhet I paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kan mbetur si dhe me trashëgimtarin e radhës së parë të ortakut të vdekur.

Neni 31
Likujdimi

1. Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja emëron një likujdus, i cili i paraqet asaj reportin e likujdimit cihe asatin e nevojshëm tö përfundimit të tij.
2. Në fund të procesit të likujdimit asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e kuotave të kapitalit mbi bilancin përfundimtar e finanziar, mbi aktin e rregullueshmërisë së punës së likujduesit dhe për mbylljen e procesit të likujdimit.
3. Pas pagimit të kreditorve dhe shlyerjes së kuotave tek kontribuesit përkatës, likujduesi ndan kapitalet e mbetur ndërmjet ortakëve proporcionalishtme pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

Neni 32

Shndërrimi I shoqërisë

Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në lloj tjetër shoqërie mund tō kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve.

**KREU IX
DISPOZITA TË TJERA**

Neni 33

Mosmarrveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund tē lindin gjatë ekzistences së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit midis ortakëve, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve, do t 'i paraqiten pér zgjidhje së Rrethit Gjyqesor Tiranë.


Neni 34

Për cështjet që nuk janë parashikuar në këtë statut do tē zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky Statut nënshkruhet nga themeluesi.

THEMELUES I VETEM SHOQËRISE

Klea Dardha



ADMINISTRATORI

Klea Dardha

